

RAPORT MONITORIMI

Mbi Ecurinë Financiare Buxhetore të AMSHC-se për 4 -muajorin e katërt të vitit 2016

Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në mbështetje të Ligjit nr. Nr. 147/2015 “Për buxhetin e Shtetit për vitin 2016”, dekretuar me dekretin e Presidentit Nr.9376, datë 24.12.2015, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” si dhe në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr.1, dt.15.01.2016 “Për zbatimin e Buxhetit të Vitit 2016” i është akorduar një fond i planifikuar prej **122 milione e 500 mijë lekë**, i detajuar si më poshtë vijon:

Tabela 1 (ne Leke)

Fondi i Pagave:	13,000,000 Lekë (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqerore:	2,500,000 leke (zeri 601)
Fondi per Shpenzime Operative:	5,000,000 Lekë (zeri 602)
Fondi per transfertat ndaj te treteve:	101,000,000 Lekë (zeri 604)
Fondi per Investimet e Trupezuara:	1,000,000 Lekë (zeri 231)
TOTAL	122,500,000 LEKE

Përgjatë Vitit financiar 2016, ka pasur ndryshime në **Planin Vjetor 2016 per Buxhetin plan të AMSHC –së** mbështetur në Aktin Normativ Nr.2, datë 16.12.2016 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, në zbatim të Urdhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” të ndryshuar si dhe bazuar në Udhëzimin plotësues nr.1 datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të Vitit 2016”, pakësimet për Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile sipas planit të rishikuar të buxhetit për vitin 2016 sipas tabelës poshtë shënuar :

Tabela e pakesimeve ne zbatim te Aktit Normativ Nr.2 dt.16.012.2016										
AGJENCIA PER MBESHTETJEN E SHOQERISE CIVILE										
Entiteti i Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kod Institucionit	Emri i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi Degese Thesarit	Kod Projektit	Emertimi i Projektit	Debit
			Pakesohet							
01	88	1088001	Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile	1	1110	600	3535			1,100,000
			Pakesohet							
01	88	1088001	Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile	1	1110	601	3535			250,000
			Pakesohet							
01	88	1088001	Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile	1	1110	602	3535			500,000
TOTAL										1,850,000

Në këtë kuadër, në mënyrë të përmbledhur saktësojmë se ndryshimet në planin fillestar të Buxhetit të AMSHC –së janë :

- Shtim ne llogarinë ekonomike 604 me 5,000,000 leke por u rialokua me kërkesën e AMSHC së dhe aprovimin e Ministrisë së Financave në llogarine ekonomike 602 mbështetur në Aktin Normativ nr.1, datë 29.07.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”
- Pakësim në llogarinë ekonomike 600 me 1,100,000 lekë
- Pakësim në llogarinë ekonomike 601 me 250,000 lekë
- Pakësim në llogarinë ekonomike 602 me 500,000 lekë

Pra i rishikuar plani i buxhetit per AMSHC- në eshte si më poshtë vijon :

Tabela 1 (ne Leke)

Fondi i Pagave:	11,900,000 Lekë (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqerore:	2,250,000 leke (zeri 601)
Fondi per Shpenzime Operative:	9,500,000 Lekë (zeri 602)
Fondi per transfertat ndaj te treteve:	101,000,000 Lekë (zeri 604)
	30,000 Lekë (zeri 606)
Fondi per Investimet e Trupezuara:	1,000,000 Lekë (zeri 231)
TOTAL	125,680,000 LEKE

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, për periudhën e raportuar, AMSHC, ka realizuar vlerën buxhetore në **118,578,573 Leke** nga totali prej **125,680,000 (PLANI I RISHIKUAR) Leke ose 94.3 %** të fondit të planifikuar vjetor.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore (zeri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me VKM Nr. 769, date 15.07.2009 dhe te VKM nr.23, dt.20.01.2016 “Për përcaktimin e numrit të Punonjësve me kontratë të Përkohshme për vitin 2016 në njësitë e qeverisjes qendrore”

Gjatë 3 - mujorit të katert të vitit 2016, numri mesatar i punonjësve është realizuar 14 punonjës faktikë.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve, si dhe i sigurimeve shoqërore, per këtë periudhë, është realizuar respektivisht;

11,282,503 Leke (zeri 600) për paga, realizimi **94.8 %**.

1,835,815 Lekë (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore, realizimi **81.5 %**.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zeri 602), për vitin 2016, është planifikuar fillimisht në vlerën **5,000,000 leke**.

Me rishikimin e Buxhetit mbështetur në Aktin Normativ nr.1, datë 29.07.2016

“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, si dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Financave nr.2, datë 27.01.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, AMSHC- se ju shtua **5,000,000 leke** ne llogarine e Granteve 604 por me kërkesën e Institucionit për rishpërndarje fondesh kjo vlere u rialokua ne llogarine e shpenzimeve operative duke bërë që totali i 602 pas rishikimit të buxhetit nëpërmjet dy Akteve Normative të Ligjit të Buxhetit të Vitit 2016, të jetë 9,500,000 leke në total llogaria e shpenzimeve operative 602.

Për këte zë, në periudhën Shtator 2016 – Dhjetor 2016 është realizuar vlere prej **4,350,455 Lekë pra 45.7 % e planit vjetor të rishikuar.**

Gjithashtu, në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC është mbështetur në nje shpërndarje sa më racionale të kërkesave, të cilat lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.
- Kyerjen e të gjitha blerjeve dhe prokurimeve të mallrave dhe shërbimeve për nevoja të AMSHC, publikime, blerje kancelarike, shërbim i pastrimit të institucionit etj.
- Krijimin e facilitetit për Udhetime pune jashtë vendit dhe brenda vendit me fokus rritjen e kapaciteteve të stafit si dhe shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira me vendet e rajonit dhe më gjërë.

Fondi në zërin për Transferime Korrente të Brendshme (zëri 604), për vitin 2016 është planifikuar në vlerën **101,000,000 leke.**

Ky është dhe zëri më me peshë në strukturën e buxhetit të AMSHC-së, duke qenë se dhe vete misioni i këtij institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet të OJF-ve përfituese si dhe mbështetjen teknike të OSHC -ve në vend.

Shënim: Mbështetur në Aktin Normativ nr.1 dt.29.07.2016 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.147/2015 “Për Buxhetin e Vitit 2016” “ AMSHC –së ju akordua një shtim në llogarinë 604 prej 5,000.000 leke pra totali i 604 për muajin shtator si plan thesari ka qënë 106,000,000 lekë. Më pas me kërkesën e Institucionit dhe miratimin e Ministrisë së Financave fondi prej 5,000,000 lekësh kaloi në llogarinë e shpenzimeve operative.

Konceptoi: L.Hasa

Për periudhen respektive është realizuar vlera prej **100,086,800 Lekë** ose **99 %** e planit (të rishikuar me aktin normativ) vjetor.

Në realizimin e këtij zëri, AMSHC-ja ka vazhduar me disbursimet e mbetura të Thirrjes 7 dhe Thirrjes 8 ndërkohë janë disbursuar tërësisht faza e parë e Thirrjes Nr.9 sipas kontratave të lidhura gjatë vitit 2016.

Fondi per shpenzim investime (zeri 231) ,

1,000,000 Lekë (zeri 231) për Investime të Trupëzuara,
Gjatë tre mujorit të katërt të vitit 2016, janë finalizuar edhe praktikatat e prokurimit dhe ndjekjes përse i përket fondit të investimeve. Konkretisht është disbursuar edhe fondi i investimit për projektin e riskonstruksionit me vlerë **480,000 lekë** me TVSH gjatë muajit Shtator 2016 si dhe ka përfunduar edhe praktika e prokurimit për projektin e dytë të Investimit atë të përmirësimit të Infraskturës së IT së në Institucion me vlerë prej **190,800 lekesh**.

Ndërkohë me kërkesën e Institucionit dhe miratimin e Ministrisë së Financave, është rialokuar fondi i investimeve pjesa e mbetur pas ndjekjes së procedurave të prokurimit për celjen e një projekti të ri investimi të tillë si "Investim në fonine e zyrës së mbledhjeve për AMSHC –në" në vlerën e celjes së projektit 329,200 dhe realizimi faktik në vlerën **322,200 leke**.

Pra realizimi i fondit të Investimeve për AMSHC në është total 993,000 leke nga 1,000,000 plan buxheti me një përqindje prej 99.3 % .